Kronikë

Tiranë/ Po transportonin 19 kg kanabis, 4 në pranga! Droga e ndarë me çanta në bagazh, 1 kg 2 mijë €! Dyshime për 'shtëpi bari' në jug të vendit (VIDEO)

Një grup kriminal është goditur nga Antidroga e Tiranës, ndërs janë kapur në flagrancë duke transportuar 19 kg kanabis.

■ Dalin fotot, kush janë 4 anëtarët e grupit kriminal që u kapën duke transportuar kanabis në bagazhin e makinës

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Sokol Dema
6 Qershor, 09:19 | **Përditesimi: 6 Qershor, 11:17**

Share

TIRANË- Një grup kriminal është goditur nga Antidroga e Tiranës, ndërsa janë kapur në flagrancë duke transportuar 19.30 kg kanabis. Droga siç shihet edhe në këto pamje ishte e futur në dy çanta të zeza në bagazhin e makinës dhe dyshohet se po sillej nga jugu i vendit për t'u shitur në kryeqytet. 4 persona kanë rënë në pranga, Gazmend Hoxha 50 vjeç, Saimir Gerbaj 54 vjeç, Aleksandër Kili 37 vjeç dhe Orgest Beqo 43 vjeç.

Burime bëjnë me dije se ky grup kriminal prej kohësh ishte i përfshirë në shitjen e lëndëve narkotike, kryesisht në Tiranë. Kanabisi i sekuestruar ishte kultivuar përmes llambave në 'shtëpi bari', thonë burime për Shqiptarja.com. Pas zbulimit të drogës, hetuesit kanë dyshime se shtëpia e barit ndodhet në jug të vendit. Antidroga e Tiranës po heton për zbulimin e vendndodhjes së banesës.

Grupi kriminal, në momentin që sillte lëndën narkotike në kryeqytet ndaheshin në dy automjete, njëra hapte rrugën dhe kontrollonte nëse ka apo jo prezencë të policisë dhe mjeti i dytë kishte në bagazh kanabisin. Kilogrami i tij shitej në treg më shumë se 2000 euro. Dyshohet se shtëpia e barit ndodhet në jug të vendit.

LEXO EDHE:
Kaluan 200 persona të padëshiruar drejt BE, gjykata e Tiranës hë në fuqi masat e sigurisë për efektivët e Rinasit dhe Eneo Sulejmanin

Ndaj 4 të arrestuarve rëndon akuza "Prodhimi dhe shitja e narkotikëve". Në momentin e ndërhyrjes së Policisë, 50-vjeçari Gazmend Hoxha ka kundërshtuar punonjësit e Policisë dhe nuk është bindur ndaj urdhrave të tyre. Ndaj tij rëndon edhe akuza "Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësit të policisë së rendit publik".

Ndërkohë, gjatë kontrollit të ushtruar në shtëpinë e 37-vjeçarit Aleksandër Kilit është sekuestruar një armë zjarri pushkë dhe 200 fara të dyshuara narkotike kanabisi.

Lajm ne perditesim....

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 10:02

Dalin fotot, kush janë 4 anëtarët e grupit kriminal që u kapën duke transportuar kanabis në bagazhin e makinës

Shqiptarja. com dhe Report Tv kanë siguruar fotot e 4 personave që u kapën në flagrancë duke transportuar kanabis në bagazhin e makinës.

Persona që kanë rënë në pranga janë, Gazmend Hoxha 50 vjeç, Saimir Gerbaj 54 vjeç, Aleksandër Kili 37 vjeç dhe Orgest Beqo 43 vjeç.

S.B/Shqiptarja.com

Share

S.B/r.k./Shqiptarja.com

TAG: Tiranë gazmend hoxha Saimir Gerbaj Aleksander Kili Orgest Beqo

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Si ju duket investigimi i Rai 3 për Shqipërinë?

Korrekt Jo korrekt Nuk e di

Lajme të tjera

LIVE - Rithemelimi 2 orë protestë para Kuvendit/ Militantët e Berishës përplasen me policinë! I prin Klevis Balliu dhe Sali Lusha! Djegin goma
6 Qershor, 10:42

Zyrtare/ Bledi Shkëmbi trajneri i ri i KF Tiranës
5 Qershor, 22:31

200 mijë € në llogarinë e shqiptarit! Kush është i huaji misterioz i hetuar në Angli për pastrim parash
5 Qershor, 13:02

Në Tiranë gara 'Vrapo për Autizmin', Veliaj: Një qytet i mirë, është qyteti që i pranon të gjithë, pa dallime
5 Qershor, 12:57

Përfitoi 17 transferta në vlerë rreth 200.000 euro, Prokuroria e Tiranës, kërkon sekuestrimin e llogarive, dyshime për pastrim parash
5 Qershor, 10:29

U hap para 5 ditësh, zjarr në biznesin e makinave me qira në Kamëz, digjen 6 mjete! Pistë hetimi konkurrenca (VIDEO)

Sokol Dema

5 Qershor, 08:35

Media britanike 'Bristol Live': Eksploroni Tiranën, kryeqytetin mahnitës shqiptar
5 Qershor, 07:51

'Real Estate në Tiranë, Histori dhe studim tregu – që nga viti 1993' Një libër befasuses i Inxhinier Lefter Silës, përcjellës njohje e kulture

Albert Nikolla

4 Qershor, 18:08

Tiranë/ Gruaja pi fotoksinë se e dhunonte burri, arrestohet 47 vjeçari! Viktimë e rrahjeve ishte dhe e bija
4 Qershor, 13:53

Protesta e 10-të e Rithemelimit para bashkisë së Tiranës, i bashkohet dhe ish gjyqtari sheik Gjin Gjoni! I vënë flakën gomave para policisë

Sokol Dema

4 Qershor, 11:55

Dhëndri i Nanos merr përsipër sulmin i vetëm: Avokatin e dhunova se m'u prek sedra! Zbulon çndodhi në takimin e vjehrrit me Mëngjesin
4 Qershor, 11:49

Ryshfet 500 € për të kaluar qytetarë drejt BE, masë sigurie për 8 efektivë të Rinasit, 1 prej tyre kërkim! U zbuluan pas arrestimit të Eneo Sulejmanajt (VIDEO)
4 Qershor, 08:33

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje